KONTRATE SHITBLERJE
KUOTE

Sot me daten 10.11.2020, ne seline e shoqerise "EN-EL" sh.p.k, e cila ndodhet ne adresen Godine 3-kateshe, prane Ures se Beshirit, Tirane,

PALET KONTRAKTUESE

Z. Petraq Shomo : i biri i Dhimitraqit, lindur me date 07.01.1963, ne Tirane, banues ne Tirane ne adresen Rrugen "Dervish Hekali", 49, mbajtës i leternjoftimit me nr. Personal G30107128Q, (i cili prej ketej e tutje do te emertohet "**Shitesi**");

Znj. Lindita Shomo : e bija e Spiros, lindur me date 25.12.1969, ne Shkoder, banues ne Tirane ne adresen Rrugen "Dervish Hekali", 49, mbajtës i leternjoftimit me nr. Personal G96225120R, ne cilesine e bashkeshortes se shitesit, (e cila prej ketej e tutje do te emertohet "**Dhenesja e pelqimit**");

dhe

Z. Artan Kapexhiu : i biri i Ruzhdiut, lindur me dt.20.04.1965, ne Tirane, banues ne Tirane, ne adresen Rruga e Kavajes, nr.16/1, Ap.5, mbajtës i leternjoftimit me nr. Personal G50420199L (i cili prej ketej e tutje do te emertohet "**Bleresi**")

bien dakord te lidhin kete kontrate shitblerje kuote, me permbajtjen qe vijon:

Kushte paraprake

- Shitesi **Z.Petraq Shomo** eshte zoterues i nje kuote qe perfaqeson 50% (*pesedhjeteperqind*) te vleres se kapitalit te shoqerise "EN-EL" shpk, e cila eshte nje shoqeri e regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit (QKB), me NIPT Nr. L22405011A e cila ushtron aktivitetin e saj tregtar ne fushen e ndertimit, tregetimit te materialeve te ndertimit dhe aktivitete te lidhura me ndertimin, dhenien me qera dhe shitje te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme etj.

- Shitesi **Z.Petraq Shomo** deklaron se eshte i interesuar dhe ka shfaqur disponibilitetin e tij per t'i shitur Bleresit kuoten qe zoteron ne shoqerine "EN-EL" ne perputhje me kushtet e kesaj kontrate.

- Bleresi **Z.Artan Kapexhiu** eshte i interesuar dhe ka shfaqur disponibilitetin e tij per te blere nga shitesi kuoten e tij qe perfaqeson 50% (*pesedhjeteperqind*) te kapitalit te shoqerise "EN-EL" sh.p.k ne perputhje me kushtet e kesaj kontrate.

Meqenese ekzistojne kushtet e mesiperme, palet bien per sa me poshte vijon :

Neni 1
Kushtet paraprake dhe Shtojcat

Kushtet paraprake konsiderohen pjese integrale e kesaj Kontrate ("Kontrata").

Neni 2
Objekti i kontrates

Me anen e kesaj kontrate, shitesi dhe bleresi kane si qellim te percaktojne kushtet dhe termat sipas te cilave shitesi Petraq Shomo merr persiper detyrimin qe t'i shese Bleresit Artan Kapexhiu 1 (nje) kuote te barazvlefshme me 50% (pesedhje-teperqind) te kapitalit te shoqerise "EN-EL" shpk, ndersa Bleresi merr persiper detyrimin qe pranoje ate (kuoten) dhe te paguaje cmimin ne masen dhe ne menyren e percaktuar ne kete kontrate.

Neni 3
Cmimi i blerjes

3.1 Shitesi bie dakord t'i shese dhe t'i transferojne Bleresit dhe ky pranon te bleje nga shitesi kuoten e tij qe perfaqeson 50% (*pesedhjeteperqind*) te kapitalit te shoqerise "EN-EL" sh.p.k, me cmimin total prej 50.000 (*pesedhjete mije*) Leke. Cmimi i shitblerjes se kuotes me marreveshje te paleve, eshte i barabarte me vleren e saj nominale.

3.2 Kundervlefta e kuotes ne vleren 50.000 (*pesedhjete mije*) Leke, do te paguhet nga Bleresi ne rruge bankare, brenda 30 diteve nga dita e nenshkrimit te kontrates, duke bere xhirimin perkates, ne llogarine personale te shitesit me Nr. 402004122, prane bankes BKT.

Neni 4
Transferimi i kuotave

Palet kontraktuese bien dakord qe transferimi i kuotes behet ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate. Transferimi i kuotes objekt kontrate do te behet efektiv ndaj te treteve, me depozitimin e kesaj kontrate ne Regjistrin e Qendres Kombetare te Biznesit, konforme kerkesave te legjislacionit shqiptar ne fuqi .

Neni 5
Deklarimet dhe Garancite e Shitesit

5.1 Ne daten e ekzekutimit te kesaj Kontrate Shitesi deklaron dhe garanton se:

a) E drejta e pronesise mbi kuoten objekt kontrate eshte fituar nga shitesi gjate marteses, per rrjedhim ne baze te nenit 74 te kodit te Familjes kuota objekt kontrate eshte ne pjese e bashkesise ligjore te shitesit, Z. Petraq Shomo dhe bashkeshortes se tij Znj. Lindita Shomo. Per kete aresye bazuar ne nenit 90/3 te Kodit te Familjes, per kete transaksion te shitblerjes se kuotes, jep pelqimin edhe bashkeshortja e shitesit Znj Lindita Shomo ;

b) Kuota objekt kontrate eshte emetuar dhe eshte shperndare ne menyre te ligjshme dhe eshte shlyer krejtesisht;

c) Shitesi deklaron se nuk ka asnje ndalim ligjor per shitblerjen e kuotes objekt kontrate dhe ka te drejte te shese (transferoje) ate lirisht tek te tretet, per shkak se Statuti i shoqerise EN-EL shpk, nuk permban asnje dispozite ndaluese qe lidhet me rrespektimin e te drejtes se parablerjes se ortakut tjeter dhe/ose me miratimin ne menyre paraprake te shitblerjes nga asambleja e ortakeve. Per rrjedhim ne mungese dispozitave statutore kufizuese/ndaluese, shitesi konforme kerkesave te nenit 89 te Ligjit nr.9901/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", deklaron se eshte i lire t'a

shese/transferoje kuoten e tij tek te tretet, pa miratimin e asamblese se ortakeve dhe pa rrespektuar te drejten e parablerjes se ortakut tjeter.

d) Shitesi deklaron se Kuota objekt kontrate, eshte e lire nga cdo lloj barre dhe ai (shitesi) ka te drejta te plota, pushtet dhe autoritet per t'a shitur dhe per t'a transferuar ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate;

5.2 Shitesi garanton Bleresin se me nenshkrimin e kesaj kontrate Bleresi fiton te drejten e pronesise mbi kuoten objekt kontrate, te barazvlefshme me 50% (*pesedhjeteperqind*) te kapitalit te shoqerise, se bashku me cdo te drejte qe lidhet me kuoten dhe gjithashtu shitesi garanton bleresin se me neneshkrimin e kesaj kontrate, ai (shitesi) humbet te drejten e pronesise mbi kuoten objekt kontrate si dhe te gjitha te drejtat qe lidhen me te.

Neni 6
Deklarimet dhe Garancite e Bleresit

Ne daten e ekzekutimit te kesaj kontrate Bleresi deklaron dhe garanton shitesin se:

a) Do te paguaje kundervleften e kuotes ne masen ne menyren dhe brenda afatit te percaktuar ne kete kontrate;

b) Bleresi deklaron se ka verifikuar Statutin e shoqerise "EN-EL" shpk, nga i cili rezulton se ai (Statuti i shoqerise) nuk permban asnje kufizim/ndalim qe e detyron Shitesin te respektoje te drejten e parablerjes dhe/ose te marre paraprakisht miratimin e asmblese per shitjen/transferimin e kuotes objekt kontrate, per rrjedhim Bleresi eshte dakort te neneshkruaje kete kontrate shitblerje;

c) Bleresi deklaron se para nenshkrimit te kesaj kontrate, se bashku me shitesin kane kryer *due diligence*-n e shoqerise, nga e cila ka marre informacion per historikun e shoqerise, per gjendjen e aktiveve dhe pasiveve te shoqerise, per gjendjen financiare te saj ne pergjithesi dhe ne vecanti per faktin se shoqeria "EN-EL" vitet financiare 2018 e ne vijim i ka mbyllur me humbje (me bilanc negativ). Ndonese ne keto rrethana Bleresi ka shfaqur disponibilitetin dhe interesin per te blere kuoten e shitesit Petraq Shomo.

Neni 7
Ligji i zbatueshem

Te drejtat dhe detyrimet e paleve te kesaj kontrate do te rregullohen dhe interpretohen ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Mosmarreveshjet që lidhen me interpretim, me permbushjen dhe zbatimin e detyrimeve reciproke qe burojne nga kjo kontrate, do te zgjidhen me mirekuptim dhe nese kjo nuk arrihet, mosmarreveshjet do te zgjidhen ne rruge gjyqesore, duke ju drejtuar Gjykates se Rrethit gjyqesore Tiranë.

Neni 9
Forcat Madhore

Asnjë prej paleve nuk do të konsiderohet përgjegjëse në qoftë se përmbushja e ndonjë dispozitë te kësaj Kontrate do të vonohet ose nuk do te realizohet si rezultat i forcave madhore dhe sidomos si rezultat i arsyeve te mëposhtme: revolucionet, trazirat, lëvizjet popullore, luftërat, greva, zjarret, përmbytjet, akte te perendise, shpronësimin, ose veprimeve të qeverisë që kufizon lirinë personale apo ato të ndërmarrjes të secilës palë.

Neni 10
Te ndryshme

10.1 Kjo Kontrate e shkruar perben marreveshjen e plote ndermjet paleve persa i perket objektit te kesaj kontrate dhe zevendeson te gjitha marreveshjet e meparshme, verbale apo te shkruara dhe te gjitha komunikimet e tjera te meparshme ndemjet paleve ne lidhje me objektin ne fjale.

10.2 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë Kontrate, çdo ndryshim i kësaj Kontrate mund të bëhet vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga të dyja Palët.

10.3 Te dyja palët janë dakord se afatet dhe kushtet e kësaj Kontrate janë konfidenciale dhe nuk mund të zbulohen para një pale të tretë, përveç sa kërkohet ligjërisht sipas ligjit në fuqi.

10.4 Kjo Kontrate është perpiluar në gjuhën shqipe, në forme shkresore ne 4 (kater) kopje te barazvlefshme, te nenshkruara nga palet, duke mbajtur secila pale kopjen e saj, ndersa nje kopje origjinale do te depozitohet ne QKB.

* * * * * * *

Kontrata, pasi perpilohet lexohet ne prezence te paleve, te cilet deklarojne se e kane kuptuar ate dhe me pas e nenshkruajne rregullisht pasi pasyron vullnetin e tyre te lire.

SHITESI

Petrag Shqmo

/_____/

BLERESI

Artan Kepedhia

DHENESJA E PELQIMIT
Bashkeshortja e shitesit

/_____/

Mandati Elektronik

Pershkrimi i Transaksionit

Emri i Klientit	: ARTAN KAPEXHIU	**Tipi i Veprimit**	: Transferte brenda Bankes
Adresa	: RR KAVAJES P.160/1 AP.5 NJESIA ADMINISTRATIVE NR 7 AL/TIRANA/1023	**Numri i Klientit**	: 402597517

Detajet e Veprimit

Numri References	:	402FIBK203420864
Emri i Derguesit	:	ARTAN KAPEXHIU
Emri i Perfituesit	:	PETRAQ SHOMO
Shuma Debituar	:	50,000.00 ALL
Shuma Krediturar	:	50,000.00 ALL
Kursi Kembimit	:	1.00
Llogaria Krediturese	:	402004122CLIDCLALLAO
Llogaria Debituese	:	402597517CLIDCLALLE5
Emri i Bankes se Perfituesit	:	BKT
Datë Valuta	:	07.12.2020
Informacion mbi Detyrimet	:	N/A
Pershkrimi	:	Likuidim per blerje kuote 50 te shoqerise
Komisioni	:	0 ALL

Shenim: Ky mandat elektronik ka vetem qëllim informues dhe nuk sherben si dokument i autorizuar. Në rast se informacioni nuk perputhet, në konsiderate merren te dhenat e bankes. Merrni pranë degeve te BKT-se nje kopje te autorizuar të transaksioneve.

Data Krijimit: 07.12.2020 15:35:49